



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BAZËS SË TË DHËNAVE DHE PUBLIKIMIT

Nr. 7767 Prot.

Tiranë, më 10.11.2022

Lënda: Njoftim

Drejtuar: Të gjithë Autoriteteve/Enteve Kontraktore

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") sjell në vëmendje të Autoriteteve/Enteve Kontraktore që, në zbatim të dispozitave ligjore të prokurimit publik, çdo procedurë prokurimi e krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (në vijim "SPE") duhet të përfundohet në SPE me *Arkivimin* e saj.

APP i kërkon Autoriteteve/Enteve Kontraktore që në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, të marrin masat e menjëhershme për të arkivuar procedurat e prokurimit të krijuara në sistem me statusin "Anulluar" apo procedurat e prokurimit të papërfunduara.

Sqarojmë se ky njoftim nuk është i vlefshëm për procedurat që janë të pezulluara nga Komisioni i Prokurimit Publik apo që janë në proces gjyqësor.

Gjithsesi, për çdo paqartësi apo informacion shtesë, ju lutemi të kontaktoni në adresën e-mail: info@app.gov.al.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Renda Kashita

